

Emri i Lëndës : Vlerësimi i të Nxënit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
PSP 673	A	Vjeshtë	2.00	2.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Albana Cekrezi, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Formim i Vazhduar					
Përshkrimi		Ky kurs ofron njohuri rreth përdorimit të praktikave dhe strategjive të vlerësimit për të përmirësuar të nxënit e studentëve. Theks i veçantë do t'i kushtohet vlerësimit autentik, praktikave, testeve të standardizuara dhe shqyrtimeve zhvillimore. Për më tepër, studentët do familjarizohen me masat për të vlerësuar nxënësit me nevoja të veçanta, ata me prirje të ndryshme, dhe nxënësit me prejardhje të shumëllojshme gjuhësore dhe kulturore.					
Objektivat		Me anë të këtij kursi studentët do të kuptojnë rëndësinë e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve dhe kompetencave. Do të mësojnë kriteret për zhvillimin e formave cilësore dhe të besueshme të vlerësimit, dhe jo vetem testeve. Me anë të këtij kursi studentët do të kuptojnë rëndësinë e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive, aftësive dhe kompetencave. Do të mësojnë kriteret për zhvillimin e formave cilësore dhe të besueshme të vlerësimit, dhe jo vete. Do të njihen me parimet kryesore që mundësojnë formimin e një forme të vlerësimit sa më efektive. Do të njihen me karakteristikat e testeve të standardizuara. Do të gjykojnë mbi mënyrën e vlerësimit sipas formave të ndryshme të intelligjencës dhe taksonomise se Bloom-it.					
Konceptet Kryesore		1.Vlerësim 2. Teknika dhe instrumente të vlerësimit 3. Lloje te vlerësimit 4. Variante të vlerësimit 5. Vlerësim i besueshëm 6. Parime të vlerësimit					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje. Domosdoshmëri e kontrollit të studentëve. Kontrolli i parë në zhvillimin e tij historik. Vlerësimi është pjesë e mësimdhënies dhe dhe i të nxënit. Hapësira që zë testimi në vlerësimin e të nxënit. Kontrollimi i njohurive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësve është pjesë përbërëse e procesit mësimor dhe edukativ. Nëpërmjet këtij kontrolli evidentohet niveli sasior dhe cilësor i njohurive, saktësive dhe shprehive që kanë përvetësuar nxënësit.						
2	Lidhja mes vlerësimit dhe të nxënit. Rolet dhe qëllimet e vlerësimit. Rëndësia e vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Vendi dhe roli i vlerësimit të të nxënit. Qëllimi dhe objektivat e të nxënit. Llojet e vlerësimit. Vlerësimi formal dhe informal, formues dhe përfundimtar.						
3	Vlerësimi formues në veprim. Zbatimi i Procesit të vlerësimit formues. Pesë pikë zgjedhjeje për përdorimin e vlerësimit formues. Përshtatja e procesit mësimor bazuar në të dhënat e performancës.						
4	Ndikimet në vlerësimin e të nxënit. Teoritë e intelligjencës, rritja e popullaritetit të testimit kompjuterik, vlerësimi alternativ. Arritja e një vlerësimi efektiv. Vlerësimi ne baze te llojeve te ndryshme të intelligjencës, inteligenca linguistike, matematikore, muzikore, hapësinore, emocionale etj. Ndikimi i tyre në përgatitjen e vlerësimit. Ndikimi i vlerësimit kompjuterik. Vlerësimi tradicional dhe vlerësimi alternativ. Ndryshimet dhe ngjasite mes tyre.						
5	Vlerësimi i objektiveve mësimore. Taksonomia e Bloom-it, aplikimi i taksonomisë.						
6	Vlerësimi i objektiveve mësimore. Taksonomia e Bloom-it, aplikimi i taksonomisë. II						
7	Korniza e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar						

8	Provim Gjysmëfinal
9	Parime në Vlerësim. Pesë parimet kryesore të vlerësimit të të nxënësve: praktikiteti, besueshmëria, vlefshmëria, autenticiteti dhe wash-back. Elementët që ndikojnë në praktikitetin e një forme vlerësimi: koha, paratë dhe burimet njerëzore. Besueshmëria e formave të vlerësimit, e ambientit, e vlerësuesit. Llojet e ndryshme të vlefshmërisë. Originaliteti i formave të vlerësimit dhe rëndësia e tyre për nxënësin.
10	Aplikimi i parimeve të vlerësimit. Hartimi i testimit në klasë, dhënia e feedback. Vlerësimi i formave të ndryshme të vlerësimit mbi skenare të ndryshme, vlerësimi sipas praktikitetit, besueshmërisë, vlefshmërisë, autenticitetit dhe washbash.
11	Vlerësimi i rezultateve kryesore të të nxënësve. Demonstrimi i njohurive dhe të kuptuarit. Demonstrimi i procedurave dhe teknikave. Dizajnimi, krijimi, performimi gjatë vlerësimit.
12	Fusha Emocionale. Në çfarë mase përfshihet përvetësimi i një vlere? Nivelet e përvetësimit të vlerave janë: Pranimi (marrja), Përgjigjja (reagimi), Vlerësimi, Organizimi, ose Karakterizimi. Fusha Psikomotorre. Një metodë e tretë e kategorizimit të objektivave është shpikur nga Harrow (1977) dhe nga Moore(2006). Taksonomia e Harrow përvijon pesë nivele të sjelljes psikomotorre, duke filluar nga imitimi i nivelit (më pak i ndërluar dhe më pak autentik) deri në nivelin e natyralizimit (më kompleksi dhe më i madhi) autentike).
13	Vendosja e notave, raportimi dhe vlerësimi i nxënësve: -Mësuesi së bashku me nxënësit përcaktojnë kritere për vlerësimin e projektit të cilat i komunikohen nxënësit që në fillim të projektit. P.sh. kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes, në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj., (në varësi të rezultateve të të nxënësve.)
14	Vlerësimi i të menduarit kritik dhe të nxënësve aktiv. Vlerësimi në mjediset e të nxënësve aktiv, hapat për thjeshtëzimin e vlerësimit gjatë të nxënësve aktiv. Vlerësimi i cilësisë së të menduarit të nxënësve përmes punëve me shkrim. Hartimi i rubrikave të vlerësimit.
15	Prezantime
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Musai, B. (2014). Metodologji e Mësimdhënies. Tirane. • Temple, C., Crawford, A., Saul, W., Mathews, S., & Mkinster, J. (2006). Strategji te Mesimdhënies dhe te te Nxeit per Klasat Mendimtare. Tirana: Qendra pe Arsim Demokratik • IZHA. (2015). Korniza e Vlerësimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar. IZHA. • Borich, G. D. (2017). Borich, Gary D. Në Effective Teaching Methods : Research-based Practice. The University of Texas at Austin. — Ninth edition. • Kraja, M. (2002). Pedagogjia. Tirane: Shtepia Botuese e Librit Universitar .	
Referenca të tjera • Dunn, L., OReilly, M., Parry, S., & Morgan, C. (2004). The Students` Assessment Handbook. Routledge Falmer. • Malloy, A. (2021). Seven Essential Considerations for Assessing Young Learners. Gjetur në https://www.modernenglishteacher.com/media/5801/metjan15_malloy. • Anderson, L., & Krathwohl, D. R. (2001). A Revision of Bloom`s Taxonomy of Educational Objectives. New York: Addison Wesley Longman, Ine. .	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të jenë në gjendje të përdorin një gamë të gjerë të masave të vlerësimit dhe të zbatojnë ato të përshtatshme.
2	Studentët do të përgatisin forma vlerësimi formale dhe jo formale.
3	Studentët do të jenë të aftë të përdorin një gamë të gjerë të mikro dhe makro aftësive për: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	25	
Kuize	0	0	
Projekte	1	35	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	4	4
Gjysmë finale	1	9	9
Provimi final	1	5	5
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			138
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.52
ECTS			6.00